

Në bazë të nenit 24 paragrafi 1 alineja 3 dhe nenit 116 paragrafi 7 të Ligjit të komunikimeve elektronike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Moldavisë numër 39/2014, 188/2014, 44/2015, 193/2015, 11/201 2018 dhe Gazetës Zyrtare të RMV 11/2019, 98/2019, 153/2019 dhe 92/2021), Drejtori i Agjencisë për Komunikime Elektronike më dt. 17.03.2023 miratoi

RREGULLORE

PËR NDRYSHIMIN E RREGULLORES PËR BARTSHMËRINË E NUMRAVE

Neni 1

Në Rregulloren për bartshmërinë e numrave (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 27/2015 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 205/2016), në nenin 6 paragrafi (5) alineja (6) pas fjalëve “kërkesa është parashtruar nga një person i paaautorizuar” shtohet teksti si vijon “që konstatohet përmes krahasimit të numrit të vetëm amë – NVAQ dhe numrit që bartet për persona fizikë ose numrit të vetëm tatimor – NVT dhe numrit që bartet për persona juridikë”.

Neni 2

Neni 18 paragrafi (2) alineja (f) në vend të: “emri, mbiemri dhe numri i vetëm amë për person fizik ose emri dhe numri i vetëm tatimor për personin juridik” duhet të qëndrojë “numri i vetëm amë – NVAQ për person fizik dhe numri i vetëm tatimor NVT për persona juridikë”.

Në paragrafin (3) të të njëjtit nen, pas fjalës identifikim, shtohen fjalët “emri dhe mbiemri për persona fizikë ose emri për subjektin juridik”.

Neni 3

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit të të njëjtës në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

Ndryshimet në këtë Rregullore do të publikohen në ueb faqen e Agjencisë për Komunikime Elektronike.

Numri ynë 0101-928/2

Shkup 17.03.2023

DREJTORI,
Jeton Akiku

